Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
N/Br. 1124/20
Datë/Datum. 02-02-2021
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.1124/20

PANELI SHQYRTUES,i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi- Kryetar, z. -Blerim Dina- Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatoret ekonomik: OE "Dielli Construction & Equipment" shpk - Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatoret ekonomik: "NPT "Haxhijaha "SHPK – Rahovec", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me kamion për mbeturina" me nr. të prokurimit: 20-7413-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – NPL "Pastrimi" sh.a, më datën: 01.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Dielli Construction & Equipment" shpk - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me kamion për mbeturina" me nr. të prokurimit: 20-7413-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – NPL "Pastrimi" sh.a.

II. VËRTETOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me kamion për mbeturina" me nr. të prokurimit: 20-7413-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – NPL "Pastrimi" sh.a,.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankues "Dielli Construction & Equipment" shpk - Ferizaj, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatoret ekonomik ankues OE "Dielli Construction & Equipment"shpk - Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 21.01.2020me nr.1124/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me kamion për mbeturina" me nr. të prokurimit: 20-7413-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – NPL "Pastrimi" sh.a, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 10, 13, 56, 60, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe neni 6 te RRUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë:25.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe eksperten teknike të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues edhe eksperten teknike te prokurimit në raportin e dt: 06.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / NPL Pastrimi sha, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është furnizim me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie te kontratës. Parashtruesi i ankesës te njëjtin propozim e ka kontestuar përmes kërkesës për ri shqyrtim, ndërsa AK, përmes vendimit ka refuzuar kërkesën me arsyetimin kryesore se vlerësimi i ofertave është bere komfor kërkesave te dosjes se tenderit dhe ne pajtim me dispozitat e LPP-se.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113): Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te

lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se bazuar ne dispozitat e nenit 10, kur paraqitet kërkesa me shkrim për qasje, AK do te siguroj qasje te arsyeshme ne mënyrë qe te kërkohet hapësirë ofertuesit për ankimim, jo ne momentet e fundit siç pretendohet nga ankuesi. Po ashtu sipas nenit 7, par 4, te RrUOPP-se, palës do ti ofrohen shkresat e kërkuara përveç atyre qe janë te deklaruara si sekret afarist dhe atë deri ne 20 faqe A4, janë te liruar nga pagesa. Parashtruesi i ankesës përmes deklaratës ne ankese potencon se 11 faqet e pranuara është detyruar ti paguaj 22 €, ankesës si prove i ka bashkangjitur edhe fletëpagesën.

Pretendimet tjera ankimore kane te bëjnë me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht potencohet se nuk ka prezantuar projektet e kërkuara sipas natyrës se ngjashme, ne vlere jo me pak se111,000.00 €uro. OE, i rekomanduar për dhënie ka prezantuar listën e projekteve te realizuara ne vlere prej rreth 1,000,000 €, projekte te cilat sipas përshkrimit janë furnizime me pajisje bujqësore, pra vlerësimi ynë është se projektet e tilla nuk mund te jene te ngjashme me natyrën e aktivitetit te prokurimit, kamion për bartje te mbeturinave.

Pretendimet tjera ankimore po ashtu kane te bëjnë me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, deklarate për specifikacionet teknike dhe Iso Certifikatat 9001-2015 për sistemimin e menaxhimit te cilësisë dhe ISO 14001-2015 për sistemimin dhe menaxhimin e mjedisit. OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar ISO certifikatat sipas kërkesës se AK-se, përderisa mos noterizimi i tyre, vlerësojmë se nuk e bëjnë një oferte te pa përgjegjshme. Po ashtu edhe origjina e produkteve është deklaruar.

Pretendimet tjera ankimore kane te bëjnë kundrejt specifikacioneve teknike te detyrueshme, përkatësisht, kontestohet kapaciteti i kompaktorit ku AK, përmes specifikacioneve teknike te detyrueshme ka kërkuar 7+1 m3, përderisa sipas katalogut te prezantuar ne ofertën e OE te rekomanduar për dhënie potencohet i njëjti kapacitet 7 m3.

Si prove se bashku me raport gjeni kopje spcifikacioneve teknike te detyrueshme si dhe kopjen e pjesës se katalogut te OE te rekomanduar për dhënie te kontratës.

Mendimi i ekspertit shqyrtues/teknik: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues- teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, te anulohet propozimi për dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne **ri vlerësim.**

Autoriteti Kontraktues, me datë: 06.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **NUK Pajtohet**

me mendimin e ekspertit shqyrtues

Nuk pajtohemi me raportin e ekspertit shqyrtues dhe teknik, sepse nuk i kane shqyrtuar pretendimet ankimore sipas nenit 9.2 te Rregullave per Parashtrim te ankesave ne OSHP, sepse Kerkesa per RIshqyrtim dhe Ankesa nuk i kane pretendimet e njejta.

Po ju drejtohemi Panelit shqyrtues me deshmi dhe prova se Oferta e OE se rekomanduar per kontrate eshte e kompletuar sipas kritereve te FDT-se dhe Njoftimit per kontrate..

Te bashkangjitur gjeni shkresen dhe deshmite konkrete:

Për: Panelin Shqyrtues te OSHP-së

Shkresa sqaruese për lenden nr.1124/20 – NPL. "PASTRIMI" Sh.a.

Te nderuar,

*Po ju shkruajm lidhur me ankesen te bere nga operatori ekonomik "**Dielli Construction & Equipment shpk**".ndaj autoritetit kontraktues **NPL."PASTRIMI"SH.A. Hani i Elezit** .qe ne bazë të informative që i kemi tek ju ka marr **numrin 1124/20.***

*Te nderuar ky OE,ka qene konkurent per procedure qe e ka zhvillur AK-ja ne fjale "**Furnizim me kamion per mbeturina**"ka dorezuar oferte per kete aktivitet dhe ne vleresim te ofertave ky OE ka dalur i pasuksesshem pasi ka çmimin me te larte se OE i rekomanduar.*

*Ky OE i pa kenaqur me vendimin e AK-se te dt.**02.12.2020**,me e dt.**03.12.2020** ka kekruar qasje ne dosje te tenderit, qasja iu ka mundesur, duke ju dhen me dt.**07.12.2020**, duke ja ofruar te gjitha shkresat qe i ka kerkuar per shiqim dhe ne kopje fizike te nevojshme duke e respektuar Rregulloren per Taksat Komunale per vitin 2020 me nr. te protokollit 7314 e dt.26.09.2019, tarifen e percaktuar per taksa nga Zyra e Prokurimit.*

Ky OE me dt.07.12.2020 ka bere kerkese per rishqyrtim ne AK dhe ne me dt.11.12.2020 i kemi kthyer pergjigjejen qe e kemi ngarkuar ne platforme dhe ne email te OE-se ankues.

Ne si AK- Konform ligjit ne fuqi e kemi pezulluar kete aktivitet.

*Ne ne pergjigjen –VENDIMIN e kerkeses per rishqyrtim ju kemi pergjigjur te gjitha pretendimeve ankimore te OE-se ne te gjitha pikat ankimore duke theksuar ne fund tek keshilla juridike se OE.: **Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund te parashtroj ankesë pranë OSHP-së.***

Ankesa pranë OSHP-se mund te dorëzohet brenda 10 ditëve pas këtij vendimi konform nenit 9.2 te Rregullave për parashtrim te ankesave në OSHP

Me dt.21.12.2020 OE, ne fjale ka dorezuar ankesë ne OSHP-dhe nga ankesa e dorëzuar shihet se ka devijuar nga rregullat per parashtrimin e ankesave duke e zgjeruar, plotesur dhe duke shtuar fakte te pa-verteta.

Me poshtë gjeni deshmit konkrete te skanuara per pretendimit ankimore qe i ka OE ankues

Pergjigjeje ne pretendimin ankimore per qasjen ne dosje te tenderit

Te nderuar panel shqyrtues dhe ekspert I vlersimit me posht gjeni e-mailin me date te shenuar se I kemi lejuar qasjen

dhe OE,ankues ka qendruar me shume se nje ore ne zyret tona duke ia mundesuar qasjen dhe duke ja kopjuar dhe kompletuar lendet e kerkuar

Pershendetje

Pershendetje te nderuar uroj te jeni mire

Po ju shkruajm lidhur me kerkesen tuaj per qasje ne dokumentet e OE, se propozuar si fituese per proceduren "**Furnizim me kamion per mbeturina**", ju njoftoj se sot rreth ores **15:00** mund te vini per qasje ne dokumentacionin e kerkuar sepse jam duke udhetuar ne Prishtine ne nje trajnim keshtu qe sot mund te vini ne oren qe ua shënuam me herët.

Me Respekt e pune të mbarë çdo te mire

1.Pretendimi Ankimor per pagesen e takese per kopje te shkresave

Ne per kete ua kemi bashkangjitur STATUTIN E NPL.Pastrimit"sh.a. ku aksionar kryesor dhe i vetem i saj 100 % eshte Komuna Hani i Elezit ,Siq theksohet ne kete statut,ne nenin 1 dhe tek neni 10 paragrafi 5 i STATUTIT , Po ashtu e keni te bashkangjitur edhe RREGULLOREN PER TAKSAT KOMUNALE PER VITIN 2020 , ku tek taksat per zyren e prokurimit jane te percaktuara tarifat per pagese qoftë te references apo te kopjimi te dosje se tenderit, prandaj pretendimi ankimor I OE-se per kete pike nuk qendron fare. Pagesa per kopjim te shkresave ka qene e mbeshtetur ne keto dokumente zyrtare STATUTI DHE Rregullorja per Taksat Komunale dhe jane leshura flete pagesa per kete.

Te gjitha keto i keni te skanuara dhe te bashkangjitur ne kete sqarim

Poashtu OE ankues na ka fyer ne ankesen e tij ne OSHP qe thote se (citim): *...Permes kesaj ne kemi marr 11 dokumente dmth.11 faqe te formatit A4 dhe* ***pale zyrtar****, na ka detyruar te paguajme nga 2 euro per faqe si kosto per shpenzime te fotokopjimit.*

*Termi **PALE** eshte term ofendues ndaj nesh si zyrtar dhe ky OE na ofendon dhe poshtron.*

2. Pretendimi ankimor se AK-ka shpallur fitues OE. "HAXHIJAHA" Rahovec, qe nuk e ka plotesuar kapacitetin teknik dhe professional

Edhe keto nuk qendrojn fare se ne si AK-kemi kerkuar Deshmi se ka perfunduar me sukese kontrata te ngjajshme ne tre vitet e fundit keto deshmi i ka oferuar OE. i rekomanduar duke na i bashkangjitur listen e projekteve , kontratat dhe referencat e natyres se ngjajshme , keto deshmi leht mund te shihen ne platforme per ju si OSHP.

OE,I rekomanduar ka realizuar kontrata te natyres se ngjajshme sepse ashtu ka qene edhe kriteri yn I kerkuar ne DOsje te tenderit dhe Njoftim per kontrate

Keto i gjeni te bashkangjitur te skanuara.(Referencat dhe kontrata e realizuara)

3.Pretendimi se nuk ka ISO standarde, apo se i ka ne formatin bardh e zi dhe mangesi tjera,

Ky pretendim nuk qendron sepse OE ankues pretendon se OE i rekomanduar ISO standardet i ka ne gjuhen gjermane, kjo nuk qendron fare sepse kete e ka vertetuar edhe eksperti ne raportin e tij se OE i rekomanduar i disponon ISO Standardet te cilat jane ne gjuhen shqipe ..

4.Pretendimi ankimor se tek specifikimi teknik ne si kinse ne AK-kemi pranuar specifikim me te vogel se ajo qe e kemi kerkuar ne listen e pershkrimit te çmimeve

*Edhe ky pretendim nuk qendron Panel i nderuar sepe ua kemi percjell te skanuar Specifikimin qe e ka ofruar OE, i Rekomanduar per kontrate eshte **7+1 meter kub hapsirë.***

***OE, i rekomduar per kontrat ne specifikimin teknik ka ofruar kamion per mbeturina 7+1m3** pra ne Specifikimin e **Hidro-Mak** ne faqen **2-9 ka ofruar 7 m3** kurse ne faqen tjeter, qe ekspertja teknike nuk e paska verejtur kete qe gjendet ne faqen e 3 te katalogut edhe nje (1m3) hapsirë.*

***Te gjitha keto i keni te skanuar bashke me kete shkresë percjellse.**.*

Pra, i sqarojme Panelit Shqyrtues se:

*OE ankues "DIELLI CONSTRUCTION"-Ferizaj, ka bere shkeljen e **nenit 9.2 te Rregullave per Parashtrim te ankesave qe thote citim: Ankesa do te dorezohet ne original tek Organi Shqyrtues i Prokurimi (OSHP) dhe njëkohësisht nje kopje e ankesës do ti dorezohet autoriteti kontraktues .***

Pretendimet ankimore duhe te jene te njejta me ato te paraqitura ne Autoritet Kontruktues

Kurse eksperti nuk i ka shqyrtuar pretendimet siq thote neni 9.2 i Rregullave per parashtrim te ankesave, sepse i ka shqyrtuar pretendimet e zgjeruar qe nuk kane qene ne kerkese per rishqyrim.

Shpresoj se paneli do ti merr ne konsiderate sqarimet dhe provat e bashkangjitura.

Operatori Ekonomik, me datë: 10.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **NUK Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Me date 06.01.2021 kemi pranuar ekspertizen nga OSHP-ja. Duam te ju informojme se ne nuk pajtohemi me trajtimin e ankeses tone, ku te bashkanggjitur e gjeni kundershtimin detal per secilin pretendim te trajtuar kunderligjshem.

Me date 06.01.2021 kemi pranuar ekspertizën e ekspertit shqyrtues të OSHP-së ku pajtohemi trajtimin e dy pretendimeve të para dhe me mendimin përfundimtarë, mirëpo e **KUNDËRSHTOJMË** plotësisht trajtimin e tre pretendimeve tjera.

|Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesional e

Ne nuk pajtohemi fare me trajtimin e pretendimit lidhur me mos noterizimin e ISO certifikatave të cilin pretendim sipas deklarimit të ekspertëve shihet se nuk e kanë pranuar si të bazuar. Kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë e cekur decidivisht se licencat e tilla duhet të jenë kopje të noterizuara andaj mos noterizimi i tyre konsiderohet si mos plotësim i kësaj kërkese dhe njëherit shkelje nga AK e nenit 59.4 të LPP-së. Ja si ka qenë kërkesa:

Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me keto Çertifikata EN—ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Çilësjsë); EN—ISO 14001 2015 (Certifikata për Sjstemin e Menaxhiniit të Mjedisit)

Eksperti nuk ka dhënë asnjë sqarim se në cilën bazë ligjore është mbështetur kur ka deklaruar se mos-noterizimi i ISO Certifikatave *(edhe pse ka qenë kërkesë decidive e dosjes së tenderit)* nuk e bënë OE të papërgjegjshëm. Nuk ka asnjë rregull ligjore të shkruar apo ndonjë interpretim ligjor ku i lejohet AK-së që të mos respektoj kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura nga vet AK-ja. Pra bazuar në këtë mendojmë se Ekspertët Shqyrtues nuk e kanë trajtuar këtë pretendim në përputhje me LPP-në dhe dispozitat ligjore që flasin për këtë qëllim dhe si pretendim duhet rishikuar nga Paneli Shqyrtues në seancën e dëgjimit kryesor.

Për sa i përket pretendimit lidhur me mos dorëzimin e **certifikatës së origjinës** duam të sqarojmë se AK ka kërkuar **certifikatën e origjinës së kamionëve** si dokument dhe si kërkesë e tillë nuk mundet të mbulohet vetëm me një deklarim të origjinës tek lista e çmimeve. Ja si ka qenë kërkesa për këtë kriter:

origjinës tek lista e çmimeve. Ja si ka qenë kërkesa për këtë kriter:

Kërkesat mbi mundësitë teknike **dke/ose** profesional e
Produktet duliet të jenë' të prodhuara nga ndonië ee mZeeeeeVeVeeee C' eeeeeEvve **vend anëtar ose kandidat për aiitarësini në BE Çertifikata e origjinës së produkteve së basliku me katalogiet për paiisien e ofruar duke përfshirë këtu edhe përshkrimin teknik të paiisies** fcAAAAAAAAAAAAAAAAAAz eeeee .AAAAAAAAAA fcAAAAAAAAAAAAAAAAAAAAAAAAAAAA eAAAZeeVee ee fcAAAZMLAAAZIBAAAAA **së ofruar dhe prigjinën e pajisjeve të cilat dufaen t ë jenë të prodhuara në nj ë vend të BE-së ose** shtet **kandidat për anëtarësim në BE, dufaet të dorëzohet në (origjinal ose kopie e dukshme)** ■/è/ee A/è AAAAz-AAAA \

eeeeV £ ■ eeeeeVeVeeeZ

Edhe këtu Ekspertët Shqyrtues nuk kanë sqaruar se ku janë bazuar deri sa kanë deklaruar se gjoja OE i shpallur fitues e ka deklaruar origjinën. Deklarimi dallon shumë nga kërkesa për dorëzim të dokumentit mbi origjinën e artikujve, andaj mendojmë se edhe këtu ekspertët kanë vepruar në kundërshtim me LPP- në përkatësisht nuk e kanë respektuar kriterin e kërkuar nga AK sipas nenit 59.4 të LPP-së i cili ishte i cekur shumë saktë tek FDT-ja.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 01.02.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, për pagesën e kopjeve qe OE ankues ka marr ne AK dhe pretendimin se AK ka shpallur fitues një OE të papërgjegjshëm, paneli shqyrtues vlerëson se sipas sqarimeve te AK-se dhe provave AK ka respektuar kriteret e kërkuara te Njoftimit per kontrate dhe te FDT-së. AK ka bashkangjitur Rregulloren per taksa tarifa dhe ngarkesa, e aprovuar nga Kuvendi Komunal Hani i Elezit, e vitit 2020, ku janë te përfshira çmimet per kopje të faqes që është 2.00 € per faqe, kurse per 11 faqe OE ankues ka paguar 22.00 €. Po ashtu AK ne sqarimet e tij, ka bashkangjitur Statutin e kompanisë sipas nenit 10 te këtij statuti e dëshmon se NPL Pastrimi Sh.a, eshte kompani publike me 100% aksione Komuna Hani i Elezit. Andaj, paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor në këtë pike është i paqëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit ankimor për shkelje të nenit 10 të LPP-së më saktësisht faktit se AK nuk i ka dhënë qasje OE ankues, paneli shqyrtues vlerëson se nga dëshmitë e emailave komunikues shihet se ky pretendim ankimor është i paqëndrueshëm.

Nga shkresat e lëndës shihet se AK komunikuar me OE ku ndër të tjera thuhet: "Po ju shkruajmë lidhur me kërkesën tuaj per qasje ne dokumentet e OE se propozuar si fituese per procedurën "Furnizim me kamion per mbeturina", ju njoftoj se sot rreth orës 15:00 mund te vini per qasje ne dokumentacionin e kërkuar sepse jam duke udhëtuar ne Prishtine ne një trajnim kështu qe sot mund te vini ne orën qe ua shënuam me herët".

Me këtë rast, AK ka respektuar nenin 5 te LPP-se (Afatet kohore) per qasje ku thuhet: ***"Afatet kohore sipas ligjit duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit".***

Pra, qasjen e dëshmon edhe OE ankues se ka qene dhe i ka marr dokumentet e kërkuara me pagese sipas Rregullores per taksa, tarifa dhe ngarkesa.

AK ka respektuar Rregulloren per taksa, tarifa dhe ngarkesa te brendshme te Komunës Hani i Elezit, pasi qe edhe kompania publike është 100% me aksione nga Komuna Hani i Elezit.

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin per referencat, paneli shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk është parashtruar edhe ne kërkesën per rishqyrtim, andaj sipas paragrafit 9.2 te Rregullave per parashtrim te kërkesës per rishqyrtim dhe parashtrim te ankesave ku thuhet se pretendimet duhet te jene te njëjta si ne kërkesën per rishqyrtim, po ashtu edhe ne ankesë, citat: "Ankesa do te dorëzohet ne origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht një kopje e ankesës do ti dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne autoritetin kontraktues", ky pretendim ankimor i OE ankues nuk është shqyrtuar nga OSHP.

Lidhur me pretendimin ankimor per ISO standarde paneli shqyrtues konform ekspertit profesional vlerëson se OE i rekomanduar i ka plotësuar kriteret e kërkuara, pasi qe i disponon certifikatat ISO 9001 dhe ISO

14001 ne gjuhen shqipe, dhe po ashtu Origjinën e produktit (kamionit) e plotëson OE i rekomanduar, Paneli shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar i plotëson dokumentet e kërkuara sipas FDT-se dhe Njoftimit per kontratë, pra nuk qëndron pretendimi i OE ankues se janë ISO standardet (9001 dhe 14001) ne gjuhen gjermane, po ashtu edhe origjinën e produktit e dëshmon OE i rekomanduar ne dosjen e tij dhe ne dëshmitë qe AK i ka sjellë përmes sqarimeve, qe dëshmon se dokumentet (ISO) janë ne gjuhen zyrtare – gjuhe shqipe. Kriteri i kërkuar i FDT-së ka qenë: **Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata EN–ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë); EN–ISO 14001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit).**

Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar e plotëson kriterin e kërkuar per ISO: Certifikata EN–ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë); EN–ISO 14001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit). Certifikatat janë lehte te verifikueshme përmes ueb faqes nga kompania TUV-NORD qe i ka lëshuar ato certifikata.

Paneli shqyrtues sqaron se AK ka pasur parasysh edhe nenin 1 të LPP-së ne kursimin e buxhetit dhe edhepse është kërkuar Certifikatat te jene te noterizuara, pasi qe ato lehte verifikohen atëherë nuk ndikon ne rezultatin e ofertës dhe sipas nenit 59.4 te LPP-së pika (ii) ky është një devijim i vogël që nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, mund te llogariten si devijime te vogla, andaj pretendimi ankimor ne këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues qe kamioni i prezantuar nuk është 7 + 1 m3, paneli shqyrtues sqaron se edhe ky pretendim nuk është ne kërkesën per rishqyrtim, andaj sipas paragrafit 9.2 te Rregullave per parashtrim te kërkesës per rishqyrtim dhe parashtrim te ankesave thotë se pretendimet duhet te jene te njëjta si ne kërkesën per rishqyrtim, po ashtu edhe ne ankesë, dhe i njëjti nuk është shqyrtuar fare nga OSHP, pasi që qartazi thuhet në këtë dispozitë ligjore se shqyrtohen vetëm pretendimet që janë parashtruar edhe në kërkesën për rishqyrtim.

Pra, AK-NPL.Pastrimi sh.a ka shpërblyer OE me çmim me te lire se OE ankues dhe duke marr parasysh kursimin e buxhetit ka vepruar konform nenit 1 te LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka shperblyer me kontratë operatorin ekonomik me cmimin me të ulët duke vepruar kështu në harmoni me nenin 1 dhe 60 të LPP-së, ku sipas paragrafit 1 të nenit 1 te LPP-së: "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të

shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK–NPL "Pastrimi" sha

1x1 OE–Dielli Construction & Equipment, shpk - Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.